



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 18 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 17.03.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM**  
**PËR ZËVENDËSIMIN E KRYESUESIT TË KOMISIONIT TË ANKESAVE**

**Neni 1**  
**Përbërja e Komisionit**

Me këtë Vendim, zëvendësohet, Avni Olluri ,Kryesuesi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme për shkak të lirimit nga detyra e punës, i caktuar sipas nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit të ankesave 15Nr.020-36027 të datës 31.05.2019 në numrin rendor 1, nga ekzekutivi i Komunës dhe në vend të tij caktohet:

Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Administratë, nga ekzekutivi i Komunës

**Neni 2**

**Detyrat , përgjegjësitë dhe mandati**

Detyrat , përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit të ankesave është i përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit të ankesave 15Nr.020-36027 të datës 31.05.2019.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

15Nr. 112-15438

Lipjan, më 17.03.2021

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

